

# Pasqyrat Financiare 2016

Bashke me opinionin e audituesit te pavarur  
**Golden Eagle Shpk**



1001 Tirana 5 , Bulevardi Deshmoret e Kombit

---

#### **Auditues**

AECO AUDIT TR  
Eniana Dupi PF (EKR)  
Rr. Perlat Rexhepi, P.6, Ap.23, K.2, Tirana

# Permbajtja

Opinioni i Audituesit te pavarur .....	1
Pasqyrat financiare .....	2 - 3
Pasqyra e performancies financiare .....	4
Kapitali .....	5
Pasqyra e flksit monetare .....	6
Shenime shpjeguese .....	7 - 22

# AECO AUDIT TR

**Eniana Dupi PF**  
**Rr.Perlat Rexhepi,Pallati6,kt.II,Ap.23**  
**Tirane, Albania**

**Cel:+355682086463**  
**TEL.:+3554500439/40**  
**Place of Registration: NRC**  
**VAT (NUIS) No: L41918003U**

## **RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR**

Drejtuar menaxherëve dhe aksionerëve të Golden Eagle Shpk.

### ***Raporti mbi Pasqyrat Financiare***

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Golden Eagle Shpk. bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

### ***Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare***

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që percaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

### ***Përgjegjësia e Audituesit***

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

### ***Opinionit***

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Golden Eagle Shpk. më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Tirana, Albania

26 Qershor 2017

Eniana Dupi

Engagement Partner

AECO AUDIT TR



(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

<b>AKTIVET</b>	Notes	31.12.2016	31.12.2015
<b>A. Aktivet Afatshkurtra</b>			
I. Mjete monetare	(4)		
1. Mjete Monetare ne Arke		7.862	2.442
2. Mjete Monetare ne Banke		103.009	423.986
		<u>110.871</u>	<u>426.427</u>
II. Inventarë	(5)		
1. Paisje per dhoma dhe materiale te tjera		3.519	4.891
2. Ushqim		4.836	4.022
3. Materjale pastrimi		756	666
4. Pije		3.493	3.216
5. Materiale per perdorim per klientet		3.519	4.337
		<u>16.124</u>	<u>17.132</u>
III. Kërkesa të arkëtueshme	(6)		
1. Llogari te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit		61.757	33.243
2. Tatimi ne Burim i Arketueshem		0	13.701
3. Te tjera llogari te arketueshme		66	3.109
4. TVSH e Arketueshme		2.003	10.106
5. Te arketueshme nga Kartat e Kreditit		50	50
		<u>63.877</u>	<u>60.209</u>
IV. Shpenzime të parapaguara	(7)		
1. Tatim Fitimi i Parapaguar		6.966	0
2. Te tjera parapagime		2.979	2.688
		<u>9.946</u>	<u>2.688</u>
		<b>200.818</b>	<b>506.457</b>
<b>B. Aktivet Afatgjata</b>			
I. Aktive afatgjata materiale	(8)		
1. Ndertesa		1.208.001	614.649
2. Programe Kompjuterike		3.957	3.713
3. Paisje/mobilje per hotelin dhe zyrat		165.415	80.900
4. Automjete		1.157	1.447
5. Ndertime ne proces		0	132.541
		<u>1.378.530</u>	<u>833.250</u>
<b>Shuma e Aktiveve</b>		<u><b>1.579.348</b></u>	<u><b>1.339.707</b></u>

Golden Eagle Shpk

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

<b>DETYRIMET</b>	Notes	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
<b>A. Detyrimet dhe kapitali</b>			
I. Detyrimet afatshkurtra	(9)		
1. Te pagueshme nga aktiviteti i shfrytezimit		232.165	26.028
2. Te tjera te pagueshme		<u>52.338</u>	<u>50.225</u>
		284.503	76.253
II. Detyrimet afatgjata	(10)		
1. Depozita - Garanci per qirate		<u>4.298</u>	<u>3.530</u>
		<b>288.802</b>	<b>79.782</b>
<b>B. Kapitali</b>			
I. Kapitali themeltar	(11)		
1. Rogner GmbH		404.019	404.019
2. Rogner International Hotels and Resort GmbH		<u>128.917</u>	<u>128.917</u>
		532.936	532.936
II. Rezerva ligjore	(12)	20.286	20.286
III. Rezerva të tjera		21.046	21.046
IV. Fitimet e pashpërndara		<u>716.278</u>	<u>685.656</u>
		<b>1.290.546</b>	<b>1.259.925</b>
<b>Shuma e Detyrimeve dhe Kapitalit</b>		<b><u>1.579.348</u></b>	<b><u>1.339.707</u></b>

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

	Notes	2016	2015
<b>1. Te ardhura</b>	(13)		
a) Të ardhura nga aktivitet i shfrytëzimit		591.549	584.190
b) Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		5.341	9.879
		<b>596.890</b>	<b>594.069</b>
<b>2. Shpenzimet</b>			
a) Materiale te Konsumueshme	(14)	-83.484	-77.406
b) Sherbime	(15)	-197.221	-177.468
c) Kosto Personeli	(16)	-139.673	-125.529
d) Zhvleresime dhe Amortizimi	(8)	-63.078	-51.570
e) Shpenzime te tjera	(17)	-63.594	-43.213
		<b>-547.051</b>	<b>-475.187</b>
<b>3. Rezultati Financiar Neto</b>	(19)		
a) Interesa dhe komisione bankare		-8.711	-7.264
b) Te Ardhura Financiare		869	-1.634
		<b>-7.843</b>	<b>-8.898</b>
<b>4. Rezultati nga Aktiviteti i Shfrytezimit</b>		<b>41.996</b>	<b>109.984</b>
<b>5. Fitimi para tatimit</b>		<b>41.996</b>	<b>109.984</b>
<b>6. Shpenzime per Tatim Fitimin</b>	(20)	<b>11.375</b>	<b>18.848</b>
<b>7. Fitimi Neto</b>		<b>30.622</b>	<b>91.136</b>
<b>8. Fitimi Neto per Periudhen</b>		<b>30.622</b>	<b>91.136</b>
<b>9. Fitimet e Pashperndara</b>		<b>716.278</b>	<b>685.656</b>

Golden Eagle Shpk

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

	Kapitali aksioner	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i pashperndarë	Totali
<b>Gjendja më 31.12.2014</b>	<b>532.936</b>	<b>20.286</b>	<b>21.046</b>	<b>588.646</b>	<b>1.162.914</b>
Zbritje ne Fitimin e Mbartur				5.875	5.875
Fitimi neto për periudhën kontabël				91.136	91.136
<b>Gjendja më 31.12.2015</b>	<b>532.936</b>	<b>20.286</b>	<b>21.046</b>	<b>685.656</b>	<b>1.259.925</b>
Zbritje ne Fitimin e Mbartur					
Fitimi neto për periudhën kontabël				30.622	30.622
<b>Gjendja më 31.12.2016</b>	<b>532.936</b>	<b>20.286</b>	<b>21.046</b>	<b>716.278</b>	<b>1.290.547</b>

Golden Eagle Shpk

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

	Notes	2016	2015
<b>1. Fitimi neto për periudhën</b>		<b>30.622</b>	<b>91.136</b>
<b>2. Rregullime për:</b>			
a. Zhvleresimi dhe Amortizimi	(8)	63.078	51.570
b. Nxjerrje jashte perdorimit e aktiveve afatgjata materiale		5.368	0
c. Fondi per zhvleresim		2.432	314
		<b>70.879</b>	<b>51.884</b>
<b>3. Ndryshime ne Kapitalin Punues</b>			
a. Ndryshime ne tepricen e Inventareve	(5)	1.008	-3.249
b. Ndryshime ne tepricen e llogarive te arketueshme	(6)	-6.100	7.210
c. Ndryshime ne tepricen e shpenzimeve te parapaguara	(7)	-291	-661
d. Ndryshime ne tepricen e Tatim Fitimit te Parapaguar	(7)	-6.966	0
e. Ndryshime ne tepricen e Llogarive/kerkesave te pagueshme		206.138	-24.808
f. Ndryshime ne tepricen e Llogarive/kerkesave te tjera te pagueshme	(9)	2.881	4.450
		<b>196.669</b>	<b>-17.058</b>
<b>4. Flukset monetare nga veprimtaria e shfrytezimit</b>		<b>298.170</b>	<b>125.962</b>
<b>5. Flukset Monetare Neto nga Aktiviteti i Shfrytezimit</b>		<b>298.170</b>	<b>125.962</b>
<b>6. Aktiviteti i Investimit</b>			
a. Blerje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		<b>-613.726</b>	<b>-181.735</b>
<b>7. Mjetete monetare neto te perdorura per aktivitetin e investimit</b>		<b>-613.726</b>	<b>-181.735</b>
<b>8. Aktivitete Financimi</b>			
a. Ndryshimet ne Fitimet e Pashperndara		<b>0</b>	<b>5.876</b>
<b>9. Mjetet Monetare Neto te perdorura ne Aktivitetin e Financimit</b>		<b>0</b>	<b>5.876</b>
<b>10. Ndryshimi Neto i Mjeteve Monetare dhe Ekuivalente</b>		<b>-315.557</b>	<b>-49.897</b>
<b>11. Mjete Monetare dhe Ekuivalente me 1 Janar</b>	(4)		
a. Mjete Monetare ne Banke		422.658	473.263
b. Mjete Monetare ne Arke		3.770	3.062
		<b>426.427</b>	<b>476.325</b>
<b>12. Mjete Monetare dhe Ekuivalente me 31 Dhjetor</b>		<b>110.871</b>	<b>426.427</b>

Keto pasqyra financiare jane autorizuar nga Drejtuesit e Golden Eagle Sh.p.k me 24 Maj 2017 dhe jane firmosur nga:

  
Mag. (FH) Thomas Spitzbart  
Administrator

Rogner Hotel Tirana  
Golden Eagle sh.p.k - Accounting  
Bvd. Dëshmoret e Kombit, AL - 1000 Tirana  
Tel.: +355 4 2235035

  
Manjola Malo  
Shëfite Finance



Golden Eagle Shpk

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

## 1. Informacion i përgjithshëm

Golden Eagle Sh.p.k. (“Shoqëria”) është themeluar më 5 Qershor 1993 në Tiranë, Shqipëri, me qëllim ndërtimin dhe menaxhimin e Hotel Rogner Tirana (Hoteli). Forma ligjore e saj është Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, dhe është e regjistruar në Rregjistrin Tregëtar me vendimin nr. 3709/1, datë 5 Qershor 1993 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Objekti kryesor i biznesit është menaxhimi i aktivitetit hotelier, i nënkontraktuar nga Shoqëria Austriake Rogner International Hotels and Resorts GmbH, e profesionalizuar në menaxhim hotelesh. Klientët kryesorë janë biznesmenë të huaj, përfaqësues të organizmave ndërkombëtare, si edhe të misioneve të huaja qeveritare.

Adresa e selisë kryesore të biznesit është Tiranë, Shqipëri.

Më 31.12.2016, Shoqëria ka pasur 145 punonjës (2015: 134) dhe aksionerë:

	2016	2015
Rogner GmbH	75,81 %	75,81 %
Rogner International Hotels and Resort GmbH	24,19 %	24,19 %
<b>Më 31.12.2016</b>	<b>100,00 %</b>	<b>100,00 %</b>

## 2. Baza e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

### (a) Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK të përmirësuar).

### (b) Baza e Matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### (c) Monedha funksionale dhe e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë, dhe janë paraqitur në mijë leke të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt.

### (d) Vlerësimet dhe gjykimet

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe çmuarjet e tyre, gjë e cila ndikon në politikën kontabël që zbatohet dhe në vlerat e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara. Rezultati faktik mund të ndryshojë prej këtyre vlerësimeve.

Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën këto rishikime kryhet si dhe në periudhat e ardhshme që mund të preken.

Në mënyrë të veçantë, informacioni që ka të bëjë me vlerësimet dhe gjykimet në aplikimin e politikave

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

kontabël të cilat kanë efekt me të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, paraqitet në shënimet respektive të pasqyrave financiare. Përdorimi i vleresimeve kontabel është minimal në keto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga shoqëria.

### 3. Politikat kontabël

Politikat e mëposhteme kontabel, janë aplikuar në mënyrë konsistente për periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### (a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet financiare dhe detyrimet të cilat janë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që janë matur me koston historike konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi zyrtar i këmbimit valuator, publikuar nga Banka e Shqipërisë ka qenë:

	31.12.2016	31.12.2015
Euro (EUR)	135,23	138,27

#### (b) Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivative njihen në hyrje me vlerën e drejtë duke shtuar, për instrumentet e mbajtur jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve që përshkruhen më poshtë. Me pas njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë në flukset monetare që vijne prej aktivitetit financiar përfundojnë ose nëse Shoqëria ia transferon aktivitetin financiar një palë tjetër pa ruajtje kontrollin apo në thelb risqet dhe përfitimet prej aktivitetit. Blerjet dhe shitjet e zakonshme të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e tregtimit, domethënë në datën në të cilën Shoqëria merr përsipër ta blejë apo shesë

Golden Eagle Shpk

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

aktivin. Detyrimet financiare çrregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë, e specifikuar kjo në kontratë, përfundojnë, pushojnë ose anulohen.

#### **Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Mjetet monetarë dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë balancat e parasë në dorë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat bankare afatshkurtra. Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozitat e pakushtëzuara me afat maturimi deri në tre muaj, ose më pak, nga data e krijimit.

#### **Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme në hyrje njihen me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

#### **Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar.

#### **Të tjera**

Instrumenta të tjere financiare jo derivativë janë matur me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në shënimin 3.k.

#### **Kapitali Themeltar**

Kapitali Themeltar i Shoqërisë matet me vlerë nominale.

#### **(c) Aktivitet afatgjata materiale**

##### **Njohja dhe matja**

Zërat e aktiveve afatgjata materiale vleresohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimet (nëse ka).

Kostoja përfshin shpenzimet të cilat mund t'i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve, koston e punës (nëse është përdorur), dhe çdo kosto tjetër që ndikon drejtpërdrejt për ta sjellje aktivitetin në kushte pune për qëllimet e parashikuara të përdorimit, si dhe koston e çmontimit dhe heqjes së objektit, si edhe të rikthimit në gjendjen fillestare të terrenit ku ata janë vendosur. Shpenzimet kapitale të aktiveve që bëhen përgjatë kohës së ndërtimit të tij, ngarkohen nën "Ndërtim në Proces" dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit në

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

momentin kur ndërtimi përfundon, moment ky në të cilin fillon të aplikohet amortizimi me normën përkatëse të kategorisë së ciles i përket aktivi.

Kur pjesë të ndryshme të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme përdorimi, atëherë ato kontabilizohen si aktive afatgjata materiale më vete (komponentë kryesorë).

#### **Kostot vijuese (e meparshme)**

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një aktivi afatgjatë material njihet si pjese e vlerës së mbetur të aktivitetit vetëm nëse pritet që në të ardhmen të rrjedhin përfitime ekonomike të perfshira në të dhe te kjo pjesë dhe nëse kostoja e saj mund të matet në mënyrë të besueshme.

Kostot e mirëmbajtjes së përditshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime në periudhën që ato kryhen.

#### **Amortizimi**

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime dhe llogaritet me metodën e vlerës së mbetur, duke filluar nga dita e pare e muajit pasues te muajit te blerjes. Aktivet me qera amortizohen duke përdorur periudhën më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qerasë dhe jetëgjatësisë së tyre të përdorimit. Toka dhe aktivet fikse të parapaguara nuk amortizohen.

Normat e amortizimit për periudhën korrente dhe ato krahasuese janë si më poshtë:

Ndërtesa	5%
Pajisje zyre dhe dhomash	20% deri në to 25%
Automjete	25%

Normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura të aktiveve afatgjata materiale, kur janë të rëndësishme, rivlerësohen në datën e raportimit.

#### **(d) Aktivet jomateriale**

Aktivitet jomateriale të blera prej Shoqërisë njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimet (nëse ka). Shpenzimet e mëtejshme kapitalizohen vetëm nëse rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të mishëruara në aktivin specifik të cilit i referohen.

Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në humbje dhe fitime ne periudhen kur ndodhin. Amortizimi njihet në humbje ose fitime mbi bazën e vlerës së mbetur me një normë 25% në vit, duke filluar që prej datës në të cilën aktivet kanë qënë të gatshme për përdorim.

#### **(e) Qira operative**

Qiratë që nuk transferojnë te Banka në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operacionale. Pagesat e qirasë operacionale njihen si shpenzime në

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin. Pagesat e bëra për qirate operative njihen në pasqyrën e të ardhurave bazur në metoden lineare përgjate kohëzgjatjes së qirasë.

#### **(f) Inventarët**

Inventarët maten me më të voglën midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është sa çmimi i vlerësuar i shitjes në një periudhe normale biznesi, minus kostot e vlerësuar të kompletimit të tij dhe shitjes.

Kostoja përfshin shpenzimet e blerjes së inventarit dhe shpenzimet e sjelljes së tij në vendin the kushtet ekzistuese. Kostoja e inventarëve të konsumuara bazohet në formulën hyrje e parë, dalje e parë.

#### **(g) Zhvlerësimi**

##### **Aktivitet financiar**

Një aktiv financiar do të konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka prova objektive që dëshmojnë se një apo më shumë ngjarje kanë pasur efekt negativ në flukset e ardhshme të vlerësuar të parasë të atij aktivi.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të vlerësuar të flukseve të ardhshme të parasë duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit. Humbja nga zhvlerësimi e një aktivi financiar të gatshëm për shitje llogaritet duke iu referuar vlerës së tij të drejtë korrente.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen individualisht përta i përket zhvlerësimit. Pjesa tjetër e aktiveve financiare, si për shembull llogaritë e arkëtueshme nga klientë të rregullt, vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe të cilet kanë të njëjtat karakteristika risku. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të vlerësuar me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### **Aktivitet Jo-financiar**

Vlera kontabël neto e aktiveve jo financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka apo jo ndonjë të dhënë për zhvlerësim. Nëse ekzistojnë të dhëna të tilla atëherë bëhet vlerësimi i vlerës së rikuperueshme të aktivitet.

Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël neto e aktivitet tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivitet dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

## **(h) Shpenzimet për Personelin**

### **Kontributet per Sigurimet Shoqerore**

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, sipas legjislacionit në fuqi, Shoqëria kryen pagesa për të kontribuar në pensionet e detyrueshme, si për llogari të saj ashtu edhe për llogari të punonjësve të saj. Kostot që i takojnë Shoqërisë paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën në të cilën ato ndodhin.

### **Lejet e zakonshme të paguara**

Shoqëria njih si detyrim shumat e plota të kostove të vlerësuara lidhur me lejet vjetore që pritet ti paguhen punonjësve përkundrejt shërbimit të tyre për periudhën e plote raportuese.

## **(i) Provigjonet**

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim të tanishëm ligjor apo konstruktiv, detyrim i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe që për shlyerjen e tij mund të jetë e nevojshme dalja e burimeve ekonomike. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të pritshme të parasë përmes një norme para tatimit që reflekton vlerësimin korrent të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të lidhura me detyrimin në fjalë.

## **(j) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga dhomat, ushqimi dhe pijet, banketet dhe shërbimet e tjera njihen në baze të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara ndërkohë që shërbimet kryhen. Në të ardhura nuk njihen detyrime të mundshme qiraje.

Të ardhurat e qirave prej qeramarrësve njihen mbi baza lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Nëse rezultati i një transaksioni që lidhet me ofrimin e një shërbimi mund të matet në mënyrë të besueshme, e ardhura e lidhur me këtë transaksion do të njihet në masën që i korrespondon fazës të kompletimit të transaksionit në datën e bilancit.

## **(k) Te ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat prej fondeve të investuara në depozitat bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit. E ardhura nga interesat njihet mbi baza rritëse.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave prej huave dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Të gjitha kostot e huamarrjes, nëse ka, do të njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

**(l) Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi për tatim fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës përbën tatimin e pritsëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës së raportimit.

**(m) Kostot e huamarrjes**

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtpërdrejt me blerjen, ndertimin ose prodhimin e aktiveve të kualifikuara, të cilat janë aktive që domosdoshmerisht kërkojnë shumë kohe për të qenë gati për përdorim ose shitje, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri sa këto aktive të jenë gati për përdorim apo shitje.

**4. Aktive monetare**

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Mjete Monetare në Arke	7.862	2.442
Mjete Monetare në Banke	103.009	423.986
	<u>110.871</u>	<u>426.427</u>

**4.1. Mjete Monetare në arke**

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Para në arke (LEK)	7.818	2.225
Para në arke (EUR)	44	217
	<u>7.862</u>	<u>2.442</u>

**4.1. Llogari bankare**

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Llogari bankare (LEK)	53.953	181.731
Llogari bankare (EUR)	46.261	224.988
Llogari bankare (USD)	2.795	17.266
	<u>103.009</u>	<u>423.986</u>

**5. Inventarët**

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Paisje për dhoma dhe materiale të tjera	3.519	4.891
Ushqim	4.836	4.022
Materiale pastrimi	756	666

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

Pije	3.493	3.216
Materiale per perdorim per klientet	3.519	4.337
	16.124	17.132

**6. Te drejta të arkëtueshme**

	31.12.2016	31.12.2015
Llogari te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit	61.757	33.243
Tatimi ne Burim i Arketueshem	0	13.701
Te tjera llogari te arketueshme	66	3.109
TVSH e Arketueshme	2.003	10.106
Te arketueshme nga Kartat e Kreditit	50	50
	63.877	60.209

**6.1. Llogari të arkëtueshme**

	31.12.2016	31.12.2015
Llogari te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit	64.190	33.557
Minus: Fondi per humbjet nga zhvleresimet	-2.432	-314
	61.757	33.243

**7. Shpenzimet e shtyra**

	31.12.2016	31.12.2015
Tatim Fitimi i Parapaguar	6.966	0
Te tjera parapagime	2.979	2.688
	9.946	2.688



(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

**8. Aktive materiale**

Aktivet materiale paraqiten te permbledhura ne tabelen e me poshtme:

Kosto	Ndërtesa	Programe kompjuterike	Pajisje zyre dhe dhomash	Automjete	Aktive fikse të parapaguara	Ndërtime në proçes	Totali
<b>Më 31.12.2014</b>	<b>1.825.791</b>	<b>25.770</b>	<b>410.061</b>	<b>3.158</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2.264.780</b>
Shtesa	31.837	1.280	16.077	0		132.541	<b>181.735</b>
Transferim nga Parapagim per Aktive Fikse							
Nxjerrje Jashte Perdorimit							
<b>Më 31.12.2015</b>	<b>1.857.628</b>	<b>27.050</b>	<b>426.138</b>	<b>3.158</b>		<b>132.541</b>	<b>2.446.515</b>
Shtesa	632.152	1.411	112.705				746.268
Transferim nga Parapagim per Aktive Fikse							
Nxjerrje Jashte Perdorimit			-31.480			-132.541	-164.021
<b>Më 31.12.2016</b>	<b>2.489.780</b>	<b>28.461</b>	<b>507.364</b>	<b>3.158</b>		<b>0</b>	<b>3.028.762</b>

Amortizimi i Akumuluar	Ndërtesa	Programe kompjuteri	Pajisje zyre dhe dhomash	Automjete	Aktive fikse të parapaguara	Ndërtime në proçes	Totali
<b>Më 1.1.2015</b>	<b>1.211.535</b>	<b>22.275</b>	<b>326.535</b>	<b>1.349</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1.561.694</b>
Ndryshime gjate vitit	31.444	1.062	18.702	362			51.570
<b>Më 31.12.2015</b>	<b>1.242.979</b>	<b>23.337</b>	<b>345.237</b>	<b>1.711</b>			<b>1.613.264</b>
Ndryshime gjate vitit	38.800	1.167	22.822	289			63.078
Nxjerrje jashte perdorimit			-26.112				-26.112
<b>Më 31.12.2016</b>	<b>1.281.779</b>	<b>24.504</b>	<b>341.947</b>	<b>2.000</b>			<b>1.650.231</b>

Vlera kontabël neto	Ndërtesa	Programe kompjuteri	Pajisje zyre dhe dhomash	Vehicles	Aktive fikse të parapaguara	Ndërtime në proçes	Totali
Më 1.1.2015	456.122	0	85.414	1.075	4.473	192.012	739.296
Më 31.12.2015	614.649	3.713	80.900	1.446		132.542	833.250
Më 31.12.2016	1.208.001	3.957	165.415	1.157			1.378.530

Golden Eagle Shpk

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

**9. Detyrimet Afatshkurtra**

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Te pagueshme nga aktiviteti i shfrytezimit	232.165	26.028
Te tjera te pagueshme	<u>52.338</u>	<u>50.225</u>
	<u>284.503</u>	<u>76.253</u>

**9.1. Të pagueshme**

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Te pagueshme nga aktiviteti i shfrytezimit	44.888	23.740
Palet e Lidhura	<u>187.278</u>	<u>2.288</u>
	<u>232.165</u>	<u>26.028</u>

**9.2. Të pagueshme të tjera**

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Detyrime te llogaritura	27.909	27.612
Kosto Personeli te Llogaritura	11.005	4.243
TVSH e pagueshme	11.453	12.341
Tatim Fitimi i Pagueshem	0	5.088
Te Tjera Detyrime	<u>1.971</u>	<u>942</u>
	<u>52.338</u>	<u>50.225</u>

**9.2.1. Detyrimet e llogaritura**

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Audtim dhe Konsulence Financiare	1.391	2.266
Pushime te pakonsumuara	22.212	21.840
Furnitore te Tjere	530	3.453
Detyrime te tjera	<u>3.776</u>	<u>53</u>
	<u>27.909</u>	<u>27.612</u>

**9.2.2. Kosto personeli të llogaritura**

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Paga	7.081	1.468
Kontribute per Sigurime & Tatimi mbi te Ardhurat	2.064	1.953
Tatim Fitimi	<u>1.860</u>	<u>822</u>
	<u>11.005</u>	<u>4.243</u>

Golden Eagle Shpk

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

**10. Detyrime Afatgjata**

<b>Detyrimet afatgjata</b>	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Depozita - Garanci per qirate	<u>4.298</u>	<u>3.530</u>

Shoqerive apo individeve te cilet marrin ambjente me qira, ju kerkohet te bejne nje derdhje ne vleren e qirase se nje, dy apo tre muajve (gje per te cilen bihet dakort ne kontrate), si garanci per permbushjen e detyrimeve kontraktuale. Kjo shume, ne momentin qe klienti largohet, i kthehet mbrapsh, totalisht apo pjeserisht ne vartesi te faktit nese ai ka permbushur ose jo detyrimet e kontrates si: pagesa e qirase, respektimi i afatit te njoftimit per mbylljen e kontrates, mos demtimi i ambientit - objekt qiraje. Kontratat e qirase jane me afat te pakufizuar.

**11. Kapitali**

Shoqëria ka lëshuar dhe autorizuar një kapital themeltar që përbehet nga 5,650 aksione me vlerë nominale të fiksuar në 1,000 USD për aksion (ose 94,325 LEK për aksion). Me 31.12.2016 kapitali themeltar eshte si më poshtë:

	Në %	Në nr. aksionesh	(në LEK `000)
Rogner GmbH	75,81 %	4,283	404.019,25
Rogner International Hotels and Resort GmbH	24,19 %	1,367	128.917,00
	<b>100,00 %</b>	<b>5,65</b>	<b>532.936,25</b>

Ne 31.12.2016 dhe 2015 ekuivalenti ne Lek i kapitalit aksioner te autorizuar eshte perkthyer duke aplikuar kursin historik te kembimit 1 USD = 94.32 Lek.

**12. Rezerva ligjore**

Në bazë të ligjit të mëparshëm shqiptar për shoqerite tregtare, kërkohej të transferohej një minimum prej 5% e të ardhurave të tyre vjetore neto në fondin e rezervës ligjore, deri sa kjo rezervë të përbënte një të dhjetën e kapitalit aksioner. Kjo shumë nuk mund të shpërndahej.

Më 14 Prill 2008, në Shqipëri hyri ne fuqi një ligj i ri për shoqeritë tregtare sipas të cilit nuk kërkohej më që shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara të njohin ndonjë rezervë ligjore.

Golden Eagle Shpk

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

**13. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

	2016	2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	591.549	584.190
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	5.341	9.879
	<u>596.890</u>	<u>594.069</u>

**Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

	2016	2015
Dhoma	311.951	305.914
Ushqim	147.310	146.622
Pije	67.237	69.405
Qira dhe të ardhura të tjera	33.337	35.171
Te ndryshme	31.714	27.077
	<u>591.549</u>	<u>584.190</u>

**14. Materjale të konsumueshme**

	2016	2015
Ushqim	-36.623	-38.161
Pije	-13.949	-14.581
Te tjera	-1.788	-1.815
Materiale për aktivitetin e shfrytëzimit	-31.123	-22.849
	<u>-83.484</u>	<u>-77.406</u>

**15. Sherbime**

	2016	2015
Shpenzime Udhetimi	-2.008	-1.639
Trainime	-50	-1.032
Auditim dhe Konsulencë Financiare	-3.397	-4.323
Rezervime	-5.330	-5.037
Pastrim të linjtash	-19.080	-19.068
Tarifa anetaresimi	-228	-436
Sherbim Sigurie	-4.443	-4.452
Internet	-2.948	-3.350
Telefoni	-2.486	-3.025
Sherbime transporti	-1.310	-623
Tarifa për Sherbime Profesionale	-10.195	-10.324
Tarifa Menaxhimi	-55.959	-53.328
Zbavitje klientesh	-2.063	-2.824
Utilitete	-35.778	-31.556
Shpenzime për Sigurime	-2.521	-2.579
Mirmbajtje	-29.581	-15.642

Golden Eagle Shpk

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

Te tjera	-19.844	-18.230
	<u>-197.221</u>	<u>-177.468</u>

**16. Kosto Personeli**

	2016	2015
Paga	-125.220	-113.363
Kontribute per Sigurime Shoq. & Shend.	-14.453	-12.166
	<u>-139.673</u>	<u>-125.529</u>

**17. Shpenzime te Tjera**

	2016	2015
Taksat Vendore	-14.539	-8.109
Shpenzime te tjera	-22.237	-11.599
Shpenzime Marketingu	-9.892	-12.701
Komisione per Agjensite e Udhetimit	-11.776	-7.974
Fondi per humbjet nga zhvleresimet	-2.432	-314
Qira Toke	-2.519	-2.420
Gjoha & Penalitete	-199	-95
	<u>-63.594</u>	<u>-43.213</u>

**18. Llogari te Perkohshme**

	31.12.2016	31.12.2015
Shpenzime nga Autofaturimi	153.281	86.334
Te ardhura nga Autofaturimi	-153.281	-86.334
	<u>0</u>	<u>0</u>

The ardhurat dhe Shpenzimet e autofaturimit janë një mekanizëm i aplikuar nga Shoqëria për qëllime të raportimit të TVSH-së lidhur me shërbimet e ofruara prej entiteteve jo-rezidente (dmth të peregjistruara për TVSH në Shqipëri).

**19. Te Ardhura Gjithperفشirese**

	2016	2015
Interesa dhe komisione bankare	-8.711	-7.264

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

Neto nga kurset e këmbimit	<u>2016</u>	<u>2015</u>
	<u>-869</u>	<u>1.634</u>

## 20. Shpenzimi për tatim fitimin

Tatimi mbi të ardhurat e kompanive është i pagueshëm në një normë prej 15% në bazë të fitimit neto për periudhën, i rregulluar për qëllime tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Pasqyra më poshtë paraqet një rikoncilim të fitimit për qëllime ligjore sipas kërkesave të ligjit tatimor:

	Viti qe mbyllet me <u>31.12.2016</u>	Viti qe mbyllet me <u>31.12.2015</u>
Fitimi para tatimit	41.996	109.984
Të ardhura të pa tatueshme		
Shpenzimet e pazbritshme	33.834	15.670
Fitimi sipas legjislacionit Shqiptar	<u>75.830</u>	<u>125.654</u>
Norma e tatimit (norma: 15%)	<u>11.374.500</u>	<u>18.848.100</u>

## 21. Palët e lidhura

Shoqëria ka marrëdhënie palësh të lidhura me shoqërinë mëmë dhe me shoqëri të tjera që janë nën një kontroll të përbashkët me Shoqërinë dhe filiale të këtyre shoqërive, drejtorët e tyre, drejtuesit ekzekutivë dhe aksionerë të tjerë. Palët e lidhura dhe marrëdhëniet respektive të Shoqërisë me to janë sa mëposhte:

- Ø Rogner International Hotels and Resorts GmbH – (aksioner)
- Ø Rogner GmbH – (aksioner)
- Ø Spa Therme Blumau Betriebs GmbH - (pjesë e grupit)
- Ø Rogner Holding GmbH - (pjesë e grupit)

Gjatë vitit 2016 dhe 2015, Shoqëria ka marrë pjesë në një sërë transaksionesh me palët e lidhura. Një përmbledhje e balancave të palëve të lidhura jepet si më poshtë:

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Rogner International Hotels and Resorts GmbH	52.093	0
Rogner Holding GmbH	14.605	0
Rogner GmbH	50.965	2.249
Spa Therme Blumau Betriebs GmbH	<u>69.615</u>	<u>39</u>

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

187.278                      2.288

Një përmbledhje e transaksioneve me palët e lidhura të përfshira në shpenzimet operative jepet si më poshtë:

**Transaksionet me Palet e Lidhura**

	<u>31.12.2016</u>	<u>31.12.2015</u>
Rogner GmbH	109.163	42.547
Rogner International Hotels & Resorts GmbH	52.093	46.574
Rogner Holding GmbH	15.537	15.264
Spa Therme Blumau Betriebs GmbH	82.792	32.546
	<u>259.585</u>	<u>136.931</u>

Shpenzimet e Rogner International Hotels and Resorts kanë të bëjnë me tarifat e menaxhimit. Shpenzimet me Spa Therme Blumau Betriebs GmbH lidhen me blerjen shërbime profesionale të menaxhimit administrativ që i janë ofruar Shoqërisë përgjatë vitit, dhe kryesisht me blerjen e mallrave. Shpenzimet e Rogner GmbH lidhen kryesisht me blerjen e mallrave dhe aktiveve, dhe shpenzimet e Rogner Holding GmbH përfshijnë shërbime konsulence të profesionale që i janë ofruar Shoqërisë.

## 22. Angazhime dhe pasiguri

### Angazhime të qirasë

Shoqëria i paguan qera vjetore Bashkise së Tiranës për përdorimin e tokës mbi të cilën hoteli është pozicionuar për një periudhë kohore maksimale prej 99 vjet e cila përfundon më 2093. Qeraja vjetore është e fiksuar në 0.94 USD për metër katror ose 20 mijë USD në vit. Qeraja është e pagueshme 6 muaj në avancë përmes dy kësteve në datat 1 Janar dhe 1 Qershor të çdo viti.

### Çështje ligjore

Shoqëria më datë 31.12.2016 është e përfshirë në pretendimet dhe çështjet gjyqësore të mëposhtme:

#### i) Rikthimi i Tokës:

Objekt i padisë është “Kërkesë për rikthim në natyrë të 1,188 metra katrorë bazuar në vendimin e vitit 1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si edhe detyrimi për pagesën e qerasë”. Çështja u fitua nga Golden Eagle në shkallën e parë më 2 Qershor 2009 dhe u apelua më 16 Qershor 2009. Gjykata e Apelit vendosi ta kthejë çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit të Tiranës. Më 13 nëntor 2011, Gjykata e Apelit me vendimin e saj Nr. 803 vendosi që Çështja duhet të kthehet në Gjykatën e Rrethit të Tiranës për tu rigjykuar nga një tjetër gjyqtar i Gjykatës së

(Shumat janë të shprehura në Mije LEK, përveçse ku parashikohet ndryshe)

Rrethit. Gjykata e Rrethit Tiranë hodhi poshtë padinë, plotësisht, me vendimin nr 6083, datë 3 Qershor 2013. Çështja u fitua në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila konfirmoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë me vendimin Nr. 2526, datë 20 nëntor 2013. Vendimet gjyqësore të shkallës së dytë janë përfundimtare. Megjithatë, paditësi ka paraqitur një ankesë në Gjykatën e Larte kundër vendimit Nr. 2526, datë 20 nëntor 2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Çështja është në pritje në Gjykatën e Lartë. Është regjistruar në të, më 24 Shkurt 2014, me nr. 11243-00602-00-2014. Deri me sot nuk është caktuar akoma data e zhvillimit të seances dëgjimore.

Shoqëria, Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Turizmit janë palë të treta në këtë padi, ku paditësi është ish pronari/pasuesi ligjor i ish pronarit dhe i paditur është Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Menaxhimi bazuar në konsulencën ligjore, beson se nuk ka ndonjë rrezik potencial ekonomik. Bashkia i ka garantuar Shoqërisë një përdorim të pacënueshëm të tokës, objekt i pretendimeve, në zbatim të Kontratës së Qerasë së Tokës.

**ii) Rikthimi i Tokës – Meri Bollano(Bollano):**

Objekt i padisë është "Anullimi i Vendimit Nr. 210, date 29.06.2009 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave" për kthimin e nje parcele toke prej 342,79 metra katrorë trashgimtarëve të Vasil Dilo, e cila ndodhet brenda perimetrit të tokës së marrë me qira nga Golden Eagle shpk për 99 vjet. Çështja është cuar ne Gjykatën e Rrethit Tirane, kohë më parë se Golden Eagle shpk te thirret në Gjykatën e Rrethit Tiranë si palë e tretë, në Korrik te vitit 2014. Golden Eagle ka mbështetur pozicionin e paditesit. Çështja eshte fituar në Gjykatën e nivelit te pare dhe te dyte. Me anë të vendimit Nr. 12450, datë 29.12.2014 Gjykata e Rrethit Tirane ka pranuar plotësisht ankesën dhe anulimin e vendimit Nr. 210, datë 11.02.2016 te Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për kthimin e pronës. Paditësi e coi çështjen në Gjykatën e Larte. Çështja eshte ne pritje ne Gjykatën e Larte.

Nuk parashikohet dëm ekonomik. Parcela e Tokës, objekt e pretendimeve, nuk përdoret. Ajo ndodhet në pjesën e pasme të Hotelit, pranë kufirit Jug-Lindor, brenda gardhit. Bashkia i ka garantuar Golden Eagle përdorim të qetë të parcelës, objekt i pretendimeve, në vijim të kontratës firmosur në vitin 1994.

**23. Ngjarje të mëpasshme**

Pas datës së raportimit nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.